**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KRYETARI**

Nr. 3046/5 prot. Pogradec, më 21. 07. 2026

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Znj. Manjola KAMOLLI**
**KRYETARE E**
**KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

*E nderuar znj. Kryetare !*

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:
**Miratimin e listës së përfituese të bashkisë pogradec në kuadër të thirrjes nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për programin e subvencionimit te interesave të kredisë**
(bashkëngjitur lista e aplikuesve/familjeve).

**Me respekt:**
**KRYETARI**
**Ilir XHAKOLLI**

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____

Bulevardi "Kreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 22.222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

Nr. ______Prot.                                                                 Pogradec, më ____.___.2026

**PROJEKT-VENDIM**

**NR.____, DATË ___.___.2026**

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESE PËR FAMILJET QË KANË APLIKUAR PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL PËR SUBVENCIONIMIN E INTERESAVE TË KREDISË"**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 22/2018 "Për strehimin social" neni 3 pika 3, neni 33 pika 1, si dhe shkresës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.628/2.prot dt.23.01.2026 mbërritur dhe protokolluar pranë bashkisë dt.28.01.2026 lidhur me thirrjen per kër kerkesat e qytetareve apo familjeve që kanë aplikuar pranë bashkisë Pogradec si dhe protalit qeveritar e-albania për **Subvencionim të interesave të kredisë**, relacioneve shpjeguese si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,dhe referuar pikës 7, të Udhëzimit të Ministrit nr.31, datë 18.11.2019;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI :**

1. Miratimin e listës fituese ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Ministrise së Ekonomisë dhe Inovacionit (bashkëlidhur relacioni me listen e aplikuesve/familjeve).

2. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R E**

**Manjola KAMOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. 3046/5 Prot

Pogradec, më 21.07.2026

**RELACION**
**MBI PROJEKT-VENDIMIN**

***"PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFITUESE PËR FAMILJET QË KANË APLIKUAR PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL PËR SUBVENCIONIMIN E INTERESAVE TË KREDISË"***

***Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:***

***Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:***
1) Akte administrative me karakter normativ
2)Akte administrative me karakter individual
3) Akte administrative me karakter kolektiv

Në Mbështetje të Nenit 13, pika 2 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar: "*Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.*"

Po kështu, në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: "*Akt me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, permes së cilës shprehet vullneti I këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që I drejtohen subjekteve të papërcaktuar të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore*".

Më tej, ky ligj në Nenin 8 , shkronja "a" përcakton se : "*është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.*"

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë Bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Bazuar në Ligjin 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:
"*Akt normativ nënligjor*" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Ky projekt-vendim nuk ka karakter normativ , pasi nuk vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte për një numër të pacaktuar subjektesh , por trajton marrëdhënje konkrete juridike ndërmjet bashkisë dhe familjeve përkatëse.

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedurave Administrative jep kete perkufizim për "Aktin administrativ":
**a)** "*Akti administrativ individual*" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektesh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
**b)** "***Akti administrativ kolektiv***" është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektesh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Në rastin e këtij projekt-vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim, i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 1 "b", të Ligjit 44/2015 të "Kodi i Procedurës Administrative", pra përbën një akt administrativ kolektiv me disa përfitues të përcaktuar , pasi i drejtohet një liste konkrete të familjeve përfituese, duke përcaktuar masën e përfitimit, strukturën familjare, tipin e banesës dhe kushtet përkatëse të subvencionimit të interesave të kredisë.

Po kështu , miratimi i këtij projekt-vendimi krijon mundësinë e përfitimit të subvencionimit të interesave të kredisë , nga familjet e përzgjedhura sipas kritereve ligjore, si dhe krijon bazën financiare dhe administrative për zbatimin e programit të strehimit social në Bashkinë Pogradec.

***Perfundimisht konkludojmë*** se: Projekt- vendimi paraqitet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë nuk kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë.
*Konceptoi: N.NAUN*

**KRYETAR**

**Ilir XHAKOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

KRYETARI

Nr. 2046/5 prot. Pogradec, më 24.02.2026

# RELACION

## "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESE PËR FAMILJET QË KANË APLIKUAR PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL PËR SUBVENCIONIMIN E INTERESAVE TË KREDISË"

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", si dhe shkresës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.628/2.prot dt.23.01.2026 mbërritur dhe protokolluar pranë bashkisë dt.28.01.2026 lidhur me thirrjen per kër kerkesat e qytetareve apo familjeve që kanë aplikuar pranë bashkisë Pogradec për subvencionimin e interesave të kredisë si dhe ne protalin qeveritar e-albania konkretisht te rubrika "Kërkesë për të Përfituar nga Programet e Strehimit Social", ju bëjmë me dije si më poshtë:

1. Të gjitha rastet dhe kërkesat, u regjistruan, protokolluan, trajtuan konform ligjit.
2. U përgatit dokumentacioni tekniko-ligjor për cdo rast.
3. U ngritën grupe pune për evidentim sipas kërkesave ku konkretisht u mbajtën proçesverbale për gjëndjen e familjeve duke shënuar të detajuar dhe konkrete të qarta pikat.
4. U plotësuan të gjitha pikat për kriteret që duhen për subvencionimin e interesave te kredise, në dosjet e tyre konkretisht vërtetime, dokumenta pronësie, çertifikata familjare dhe personale, karta id, planimetri e banesave, vërtetime, etj...
5. Të gjitha Kërkesat u verifikuan nga Komisioni i Strehimit miratuar me VKB.
6. Llogaritja është bërë sipas tabelës më poshtë (sipas Ligjit 22/2018 "Për Strehimin, Referencës së Çmimeve për $m^2$ sipas ASHK, Shpenzimeve mesatare për familje sipas INSTAT, Strehimi.

**Tabela 1**

| Struktura Familjare (Anetare) | Tipi Banesës (Apt) | Siperfaqja Normative $m^2$ | Kufiri maksimal i kredisë/familje (Lek të reja) | Shpenzimet INSTAT (Kufiri bazë) LEK | Niveli maksimal i tëardhurave (shpenzime +kësti) LEK | Niveli minimal i të ardhurave (mbulimi i këstit) LEK |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 - 2 | Garsoniere | 50 $m^2$ | 2,495,000 | 62,100 | 74,000 | 31,500 |
| 3 | 1 + 1 | 65 $m^2$ | 3,243,500 | 91,418 | 106,800 | 37,800 |
| 4 | 2 + 1 | 80 $m^2$ | 3,992,000 | 109,700 | 120,400 | 44,000 |
| 5 + | 3 + 1 | 100 $m^2$ | 4,990,000 | 100,000 | 123,500 | 52,500 |

Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 2222[illegible], Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

- *Konfirmimi apo aprovimi i çdo kërkese do të miratohet pasi ti ketë plotësuar çdo pikë, vërtetim apo shkresë që kërkohet sipas shkresës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (lidhjet 1,2, të publikuara në faqen zyrtare)*
-

Sa më sipër, duke ju falenderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin, kërkojmë konfirmimin për aprovim për familjet sipas listës së familjeve aplikuese bashkëngjitur relacionit.

Konceptoi: E.LATIFLLARI, D.DRAGOJ
Pranoi: E.DULELLARI
Miratoi : N.TORRA
Konfirmoi: P.ZIKO

**KRYETAR**
**Ilir XHAKOLLI**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

LISTA E PIKËZIMIT ME EMRAT PER FAMILJET APLIKUESE PER SUBVENCINIMIN E INTERESAVE TË KREDISË 2026

| NR. | EMER/MBIEMËR | KUSHTET E STREHIMIT | KUSHTET FAMILIARE | KUSHTET SOCIALE | KUSHTET EKONOMIKE | PIKËT TOTALE | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ALBA THANA | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 2 | ANILA MAXHARI | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 3 | ANISA HAMATI | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 4 | ARBEN DERVISHLLARI | X | – | – | X | 15 PIKË | |
| 5 | ARBRI BERBERI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 6 | ARINGA HASANLLI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 7 | ARJOLA HAZIZI | X | X | X | X | 25 PIKË | |
| 8 | ARMAND LAZELLARI | | | | | | PAS KOMINUKIMIT I PADISPONUESHËM |
| 9 | ARTAN ADRI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 10 | ASTRIT GOZHDARI | | | | | | TËRHIQET PËR DHURIM PASURIE |
| 11 | AURORA OSHAFI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 12 | BLERINA MALÇELLARI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 13 | BLERTA ÇEKIÇI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 14 | ELTON KAJAÇKA | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 15 | ENERIK BEGO | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 16 | ENGJËLL SEITLLARI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 17 | ERIDION BLACËRI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 18 | ERJON FERO | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 19 | ERJON HOXHA | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 20 | ERJONA MEÇO | | | | | | TËRHIQET VULLNETARISHT PAS KOMUNIKIMIT |
| 21 | FATOS YZELLARI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 22 | FRANC NIKOLA | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 23 | GJERGJI BINISHI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 24 | IRENA BERBERI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 25 | JETNOR BYLYKBASHI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 26 | KISIAN SHAHINI | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 27 | KLAJDI PILLATI | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 28 | KRISTINA ISALLARI | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 29 | KRISTJANA KULLOLLI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 30 | LINDITA ABESHI | | | | | | TËRHIQET PËR ARSYE PERSONALE |
| 31 | LINDITA SHKULLAKU | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 32 | MANJOLA NIÇA | X | - | - | X | 15 PIKË | |
| 33 | MILENA ÇEKREZI | X | X | - | X | 21 PIKË | |
| 34 | MIRELA VAKO | | | | | | TËRHIQET PËR ARSYE PERSONALE |
| 35 | MONDA LUSHKA | X | X | - | X | 15 PIKË | |
| 36 | REDI KAZERMA | | | | | | TËRHIQET PËR ARSYE PERSONALE |
| 37 | RENATO SEITI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 38 | RUDINA GURI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 39 | SIDORELA KASMOLLARI | X | X | - | X | 20 PIKË | |
| 40 | SONILA BAZELLI | X | - | - | X | 15 PIKË | |
| 41 | TONALDA TONA | X | X | - | X | 21 PIKË | |
| 42 | XHENSILA MUSKA | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 43 | XHOANA ÇINARI | X | X | X | X | 23 PIKË | |
| 44 | XHUMAI NIKOLA | X | X | - | X | 22 PIKË | |
| 45 | ZABIKO KUJTIM ZYKO | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 46 | ZHULIETA HIMA | X | - | - | X | 15 PIKË | |
| 47 | SERTJONA ZEQOLLARI | X | - | - | X | 15 PIKË | |
| 48 | REDINA SHAQOLLARI | X | - | - | X | 15 PIKË | |
| 49 | ALBINA SOFTA | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 50 | ERMIRA XHAJA | | | | | | TËRHIQET PËR ARSYE PERSONALE |
| 51 | ANISA NDINI | X | X | - | X | 20 PIKË | |
| 52 | ANAIRIDA KUJTIM | X | - | - | X | 15 PIKË | |
| 53 | RAMIZ PURA | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 54 | XHULIA ÇELA | X | X | - | X | 20 PIKË | |
| 55 | ADRIAN HAXHI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |

PS: 1. TË KUALIFIKUAR JANË 24 FAMILJE

2. TË SKUALIFIKUAR JANË 31 FAMILJE

LISTA E FAMILJEVE TË KUALIFIKUAR PER SUBVENCINIMIN E INTERESAVE TË KREDISË 2026

| NR. | EMER/MBIEMËR | KUSHTET E STREHIMIT | KUSHTET FAMILIARE | KUSHTET SOCIALE | KUSHTET EKONOMIKE | PIKËT TOTALE |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ANILA MAXHARI | | | | | 20 PIKË |
| 2 | ANISA HAMATI | | | | | 22 PIKË |
| 3 | ARBEN DERVISHLLARI | | | | | 15 PIKË |
| 4 | ARJOLA HAZIZI | | | | | 25 PIKË |
| 5 | ENERIK BEGO | | | | | 22 PIKË |
| 6 | ERJON HOXHA | | | | | 20 PIKË |
| 7 | FRANC NIKOLA | | | | | 22 PIKË |
| 8 | KISIAN SHAHINI | | | | | 20 PIKË |
| 9 | KLAJDI PILLATI | | | | | 22 PIKË |
| 10 | KRISTINA ISALLARI | | | | | 20 PIKË |
| 11 | MANJOLA NIÇA | | | | | 15 PIKË |
| 12 | MILENA ÇEKREZI | | | | | 21 PIKË |
| 13 | MONDA LUSHKA | | | | | 15 PIKË |
| 14 | SIDORELA KASMOLLARI | | | | | 20 PIKË |
| 15 | SONILA BAZELLI | | | | | 15 PIKË |
| 16 | TONALDA TONA | | | | | 21 PIKË |
| 17 | XHOANA ÇINARI | | | | | 23 PIKË |
| 18 | XHUMAI NIKOLA | | | | | 22 PIKË |
| 19 | ZHULJETA HIMA | | | | | 15 PIKË |
| 20 | REDINA SHAQOLLARI | | | | | 15 PIKË |
| 21 | ANISA NDINI | | | | | 20 PIKË |
| 22 | ANAIRIDA KUJTIM | | | | | 15 PIKË |
| 23 | XHULIA ÇELA | | | | | 20 PIKË |
| 24 | SERTJONA ZEQOLLARI | | | | | 15 PIKË |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC**

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE

SEKTORI I STREHIMIT, SHPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË STREHIMIT

**Nr. 2 / Datë: 16 / 07 / 2026**

Në Drejtorinë e Emergjencave më datë 16 / 07 / 2026, u zhvillua mbledhja e Komisionit të Strehimit, i ngritur pranë BASHKISË POGRADEC, për shqyrtimin e aplikimeve për përfitimin e **subvencionimit të kredisë**, për familjet në nevojë.

## 1. PËRBËRJA E KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë:

1. SHPËTIM DUTE
2. IVANA CAPOLLARI
3. VJOLLCA ALLAHA
4. NEXHMI TORRA
5. ARITAN BALLIU
6. ARBER MALE
7. PASKALINO ZIKO

## 2. RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i aplikimeve të paraqitura nga aplikuesit për subvencionimin e kredise.
2. Verifikimi i dokumentacionit dhe plotësimi i kritereve ligjore.
3. Vlerësimi dhe pikëzimi sipas sistemit në fuqi.
4. Hartimi i listës përfituese.

## 3. SHQYRTIMI I APLIKIMEVE

Komisioni shqyrtoi gjithsej 55 aplikime të paraqitura brenda afatit ligjor.

Pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se:

- 24 aplikime janë të **rregullta dhe të plota;**
- 31 aplikime janë **të paplota / të skualifikuara** për shkak të:

- mungesë dokumentacioni;
- mosplotësim kriteresh;
- deklarime të pasakta.

## 4. VLERËSIMI DHE PIKËZIMI

Komisioni bëri vlerësimin e aplikantëve bazuar në kriteret ligjore në fuqi, si:

- Të ardhurat familjare;
- Numri i anëtarëve të familjes;
- Kushtet e banimit;
- Statusi social (persona me aftësi të kufizuar, familje njëprindërore, etj.);
- Faktorë të tjerë sipas legjislacionit përkatës.

Tabela e pikëzimit bashkëlidhet si **Aneks 1** i këtij procesverbali.

## 5. VENDIMI I KOMISIONIT

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit, Komisioni vendosi:

- Të miratojë listën përfituese me 24 familje që plotësojnë kriteret për subvencionimin e kredisë;
- Të refuzojë 91 aplikime për shkak të mosplotësimit të kritereve;
- Lista përfundimtare bashkëlidhet si **Aneks 2** dhe do të publikohet sipas procedurave në fuqi.

## 6. ANKIMET

Aplikantët kanë të drejtë ankimi brenda 5 ditëve nga data e publikimit të listës, pranë BASHKISË SARANDË (institucioni përkatës).

## 7. MBYLLJA E MBLEDHJES

Mbledhja u mbyll në orën 12:00.

Ky procesverbal u hartua dhe u nënshkrua nga të gjithë anëtarët e komisionit.

## NËNSHKRIMET

Shpëtim Duka
Irana Cepollari
Ujkan Ploko
Medani Forra
ARIAN BALLIU
Arbër Malo
Paskalino Ziko

LISTA E PIKËZIMIT ME EMRAT PER FAMILJET APLIKUESE PER SUBVENCINIMIN E INTERESAVE TË KREDISË 2026

| NR. | EMER/MBIEMËR | KUSHTET E STREHIMIT | KUSHTET FAMILJARE | KUSHTET SOCIALE | KUSHTET EKONOMIKE | PIKËT TOTALE | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | ALBA THANA | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 2 | ANILA MAXHARI | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 3 | ANISA HAMATI | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 4 | ARBEN DERVISHLLARI | X | – | – | X | 15 PIKË | |
| 5 | ARBRI BERBERI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 6 | ARINGA HASANLLI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 7 | ARJOLA HAZIZI | X | X | X | X | 25 PIKË | |
| 8 | ARMAND LAZELLARI | | | | | | PAS KOMINUKIMIT I PADISPONUESHËM |
| 9 | ARTAN ADRI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 10 | ASTRIT GOZHDARI | | | | | | TËRHIQET PËR DHURIM PASURIE |
| 11 | AURORA OSHAFI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 12 | BLERINA MALÇELLARI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 13 | BLERTA ÇEKIÇI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 14 | ELTON KAJAÇKA | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 15 | ENERIK BEGO | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 16 | ENGJËLL SEITLLARI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 17 | ERIDION BLACËRI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 18 | ERJON FERO | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 19 | ERJON HOXHA | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 20 | ERJONA MEÇO | | | | | | TËRHIQET VULLNETARISHT PAS KOMUNIKIMIT |
| 21 | FATOS YZELLARI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 22 | FRANC NIKOLA | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 23 | GJERGJI BINISHI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR MOS PLOTËSIM DOKUMENTACIONI |
| 24 | IRENA BERBERI | | | | | | SKUALIFIKIM PËR TEJKALIM TË ARDHURASH |
| 25 | JETNOR BYLYKBASHI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |
| 26 | KISIAN SHAHINI | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 27 | KLAJDI PILLATI | X | X | – | X | 22 PIKË | |
| 28 | KRISTINA ISALLARI | X | X | – | X | 20 PIKË | |
| 29 | KRISTJANA KULLOLLI | | | | | | TËRHIQET PËR MARRJE KREDIE ME INTERESA TREGËTARE |

Shpallur : Dt: 30.6.2026

# NJOFTIMI PUBLIK

Në kuadër të thirrjes se aplikimit per e Programit Social të Strehimit Bashkia Pogradec, shkresës së Ministrise se Ekonomise dhe Inovacionit nr.628/2 dt.23.01.2026, ju njoftojme për hapjen e thirrjes për aplikim për fazën e parë per "Subvencionimi i Interesave të Kredisë".

Të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre (faza 1) për "Programin Social të Strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" pranë Njësive Administrative/Lagjeve nga data 30.06.2026 deri në datën 10.07.2026.

Programi Social i Strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social i strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë", do të jenë:

a) Individë të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç;
b) Familjet të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
c) Familjet që zotërojnë të ardhura brenda kufijve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

**Tabela nr. 3 - Të ardhurat minimum dhe maksimum të përfituesve potencialë**

| Struktura Familjare (Anetare) | Tipi Banesës (Apt) | Siperfaqja Normative $m^2$ | Kufiri maksimal i kredisë/familje (Lek të reja) | Shpenzimet INSTAT (Kufiri bazë) LEK | Niveli maksimal i tëardhurave (shpenzime +kësti) LEK | Niveli minimal i të ardhurave (mbulimi i këstit) LEK |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 - 2 | Garsoniere | 50 $m^2$ | 2,495,000 | 62,100 | 74,000 | 31,500 |
| 3 | 1 + 1 | 65 $m^2$ | 3,243,500 | 91,418 | 106,800 | 37,800 |
| 4 | 2 + 1 | 80 $m^2$ | 3,992,000 | 109,700 | 120,400 | 44,000 |
| 5 + | 3 + 1 | 100 $m^2$ | 4,990,000 | 100,000 | 123,500 | 52,500 |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr. 3787/5 Prot. Pogradec, më 28.08.2023

**VENDIM**

**NR. 104, DATË 27.08.2023**

**"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PËR VITIN USHTRIMOR 2023-2024 SIPAS LIGJIT NR. 22/2018 ME DISA NDRYSHIME ME LIGJIN NR. 48/2023 DATË 22.06.2023"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**KËSHILLI BASHKIAK**

1. Pranë Bashkisë së Pogradecit ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.

3. Komisioni i Strehimit përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1) Nënkryetar i Bashkisë Pogradec | (Paskalino Ziko) | Kryetar |
| 2) Drejtor i Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit të Tokave Bujqësore në Njësitë Administrative | (Besmira Niko) | Anëtar Nexhmi |
| 3) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale | (Ivana Llakmani) | Anëtar |
| 4) Përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve | (Dritan Balliu) | Anëtar |
| 5) Përfaqësues i Komuniteteve të Interesuara (Rome/Egjyptiane) | (Shpëtim Dute) | Anëtar |
| 6) Anëtar i Këshillit Bashkiak | (Arbër Male) | Anëtar |
| 7) Anëtar i Këshillit Bashkiak | (Vjollca Pllaha) | Anëtar |

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (Sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore").

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**

Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441. E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 0276/13 Prot.

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM

NR. 64, DATË 29.05.2024

**"PER MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË".**

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 22/2018 "PËR STREHIMIN SOCIAL" përkatësisht: Nenit 2, pika: 13,14,15,20,25,27,44,49, 51; Neni 3, pika 3 ; Neni 40,41,42,43 *"Subvencionim i Interesave Të Kredisë"*, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për sistemin e pikezimit mbi projektin **"Subvencionim i Interesave Të Kredisë"**.

| | SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT "SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË" | |
|---|---|---|
| NR. | KRITERET E PIKËZIMIT | PIKËT |
| A | KUSHTET E STREHIMIT | 25 |
| i | Nuk disponojnë banesë në pronësi | 6 |
| ii | Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqyqësor. | 5 |
| iii | Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë. | 5 |
| iv | Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave ne fuqi. | 4 |
| v | Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga proçesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike. | 5 |
| B | KUSHTET FAMILJARE | 25 |
| i | Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë,ku përfshihen edhe vajzat nëna. | 5 |
| ii | Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore. | 0 |
| iii | Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë. | |

| | | |
|---|---|---|
| v | Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë moshë jo më të madhe se 40 vjeç. | 7 |
| C | KUSHTET SOCIALE | 25 |
| i | Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie. | 4 |
| ii | Individë më statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç. | 2 |
| iii | Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve. | 0 |
| iv | Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese. | 2 |
| v | Familjet e policëve të rënë në detyrë. | 0 |
| vi,<br>vii,<br>viii | Punonjës i reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH<br>Punonjësit e repartit RENEA<br>Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit | 3 |
| ix | Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit | 3 |
| x | Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian | 4 |
| xi | Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit. | 2 |
| xii | Vajzat Nëna. | 3 |
| xiii | Individët që i përkasin komuniteti LGBTI, të cilët janë viktima për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor | 2 |
| D | KUSHTET EKONOMIKE | 25 |
| i | Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore. | 7 |
| ii | Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore. | 9 |
| iii | Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore. | 9 |
| | TOTALI PIKË | 100 |

**KRYETARE E KËSHILLIT**

**Manjola KAMOLLI**

1.Miratuar me 22 vota

2.Vota Pro 22

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.05.2024

Bulevardi "Reshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË, ADMINISTRIMIT TE TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 535/1 prot. Pogradec, më 09.02.2026

Lënda: **NJOFTIM PUBLIK**

## THIRRJE PËR APLIKIME-KËRKESË PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL,PËR RIKONSTRUKSION DHE PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TE BANESES PER FAMILJET NE NEVOJË

Në zbatim dhe mbeshtetje të ligjit 87/2025 "Per buxhetin e vitit 2026", ligjit 22/2018 "Per strehimin social", Ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjit 119/2014 "Per te drejten e infomimit" si dhe shkreses Nr.628/2.prot nga Ministria e Ekonomise dhe Inovacionit,Drejtoria e Strehimit, mberritur prane bashkise Pogradec me dt.28.01.2026 protokolluar me nr.628/1 lidhur me **hapjen e thirrjes per projektet e reja per programet e strehimit 2026**. njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar të paraqesin aplikimet e tyre.

**1.Aplikimi do të kryhet online në portalin qeveritar e-albania dhe ADISA.**

**2.Afati i pranimit te kerkesave do te jete deri në dt.13.02.2026**

Individi/familja e interesuar, paraqet kërkesën në portalin qeveritar e-albania, në shërbimin kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social, duke ngarkuar deklaratën për dhënien e pëlqimit për përdorimin e të dhënave personale, si dhe për të ngarkuar dokumentacionin që lidhet me kushtet e përgjithshme, si dhe kushtet e veçanta:

Për çdo informacion dhe suport tjetër mund të drejtoheni në strukturat përgjegjëse, Drejtoria e Emergjencave,Strehimit, Pronesise dhe bashkepronesise, Administrimit të tokës dhe Supervizimit te sherbimeve, pranë Bashkisë Pogradec.

Ju faleminderit për mirekuptimin dhe bashkepunimin!

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

**ME URDHËR DHE DELEGIM**
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**
**DRIT[illegible]**

Bulevardi "[illegible]" Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

535
28.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT**
**DREJTORIA E STREHIMIT**

Nr. 628/2 Prot. Tiranë, më 23/01/2026

Lënda: Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026

BASHKISË POGRADEC

Në zbatim të Ligjit nr. 87/2025 "*Për buxhetin e vitit 2026*", Ligjit nr. 22/2018 "*Për strehimin social*", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi, ju bëjmë me dije mbi hapjen e thirrjes për projekte të reja për programet e strehimit për vitin 2026; mbi Termat e Referencës, afatet, Dosjen/ Formularët e Aplikimit dhe kushtet për përfitimin e fondeve buxhetore.

Dosja e Aplikimit, dokumentacioni që do të shoqërojë formatin e aplikimit, kriteret skualifikuese, tabelat përkatëse, sistemi i pikëzimit dhe kufijtë e financimit/ bashkëfinancimit jepen në *Lidhjen* nr. 1 dhe Lidhjen nr. 2 (bashkëlidhur).

Kërkesa për financim duhet të dërgohet pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, brenda datës 16/02/ 2026, e shoqëruar me Dosjen e Aplikimit (sipas Lidhjeve nr. 1 dhe nr .2).

Të gjitha tabelat përmbledhëse të dërgohen edhe në soft copy, në formatin excel, në adresën e email-it: drejtoria.strehimit@ekonomia.gov.al.

Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 do të publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Duke Ju falënderuar,

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**

# 3. KREDI TË BUTA

## A. FAMILJA DUHET TË PLOTËSOJË KUSHTET :

1) **Nuk ka banesë në pronësi.** Familja e cila duhet te jete banore ne rrethin ku ben aplikimin, nuk duhet të ketë banesë në pronësi as kryefamiljari dhe as anëtarët e familjes nuk duhet të kenë prona në pronësi (në gjithë territorin e republikës së Shqipërisë) pasi nëse kanë, nuk përfitojnë. (vetem ne disa raste te veçanta si psh kur familja jeton te prinderit ose kur banesa eshte e pabanueshme e cila do te vertetohet nga organet kopetente ligjore)
2) **Ka të ardhura të mjaftueshme** sipas ligjit te vërtetuara me vërtetime si psh pagë, të ardhura nga biznesi ose nga qeraja etj... (të ardhurat sipas ligjit)

## B. PLOTËSIMI I FORMULARIT TË APLIKIMIT

1) Formulari plotesohet nga vete aplikanti ne portalin qeveritar zyrtar e-albania (mosplotesimi kusht per vet-skualifikim).
2) Dokumentat/ Vertetimet që duhet të sjellë qytetari në bashki ;
    1. Kërkesë elektronike ne ealbania dhe zyrtare në ADISA,
    2. Kartë ID, Çertifikata familjare dhe personale për të gjithë pjestarët,
    3. **Vërtetime** të ardhurash për të gjithë pjestarët mbi 18 vjeç,
    4. **Vërtetim** nga DPT drejtoria e tatimeve që anëtarët sipas certifikatës familjare që janë mbi 18 vjeç nuk ushtrojnë aktivitet privat (nuk ka biznes),
    5. **Vërtetim** nga drejtoria e sigurimeve shoqërore (pension ose invaliditet),
    6. **Vërtetim** nga zyra e punës (ealbania),
    7. **Vërtetim** nga ASHK (për të gjithë pjestarët mbi 18vjeç) që nuk kanë ose kanë prona në gjithë territorin e republikës së Shqipërisë (ose qe jetojne ne kushte te pa pershtatshme psh jetojne tek familja e prinderve ose nese kane banese ne pronesi te pa banueshme ose te rrenuar do te duhet e vërtetuar me foto video relacion nga emergjencat dhe nga instituti i ndërtimit Tiranë dhe instituti i shërbimit gjeologjik),
    8. **Deklaratë noteriale** (ose personale) që nuk përfiton asnjë nga programet e strehimit,
    9. **Të tjera** (dokument invaliditeti, vërtetim për statusin si i pastrehë, vërtetim jetim, vërtetim rom/egjiptian, familje njëprindërore, e/i divorcuar etj...)
3) Dokumentat dhe **hapat ligjorë** që ndjek bashkia ;
    1. **Regjistrim** i kërkesës, protokollimi, krijimi i dosjes,
    2. **Verifikim** i dokumentacionit që ka sjellë aplikuesi (të ardhurat sipas manualit),
    3. **Përzgjedhja** dhe pikëzimi i listës fituese.
    4. **Përgatitja** e dokumentacionit për vendim (relacion shpjegues, lista e familjeve përfituese, pikëzimi, projekt-vendimi, dosje individuale e aplikantit etj...).
    5. **Dërgimi** i dosjes në këshillin bashkiak për vendim,
    6. **Lidhja** e kontratës te noteri (bashki, banke, individ) proçedura pas VKB-së, bashkia i dërgon listën bankës që zbaton programin (banka analizon, verifikon

dhe vendos për lidhjen e kontratës së kredisë me familjen (ku një pjesë ose i gjithë interesi do të subvencionohet nga shteti),

7. **Verifikim** në terren (zakonisht hartoet raport social mbi kushtet e jetesës),

4) Dokumentat dhe **hapat ligjorë** që ndjek banka ;

1. **Verifikon**, arkivon (ose miraton) listen e familjeve përfituese që ka dërguar bashkia të miratuar në këshillin bashkiak,
2. **Pret** familjen per takim dhe konsulte (degjese)
3. **Banka** bën analizen financiare te kredisë
4. **Verifikon** ose plotëson dokumenta (banka, bashki, individ),
5. **Verifikon** kontratën paraprake të blerjes së banesës e cila lidhet te noteri midis pales blerese dhe shitese (akt premtim shitje ose specifikim paraprak),
6. **Vërtetim** page dhe historikun e kreditit per individet nese ka
7. **Dokumenti** i banesës që do të blihet (harte, kartele, certifik prone, planimetri),

## C. MBLEDHJA E DOKUMENTEVE

1) **Dokumentat** mblidhen ne nje dosje te aplikantit nga zyra e strehimit ne bashki nga nje specialist/e i caktuar duke kontaktuar dhe aplikantin.

## D. VLERËSIMI NGA KOMISIONI I STREHIMIT

1) **Vlerësimi** behet nga komisioni i sektorit te strehimit ne bashki sipas ligjit.
2) **Pikëzimi** sipas kritereve dhe vertetimeve qe aplikanti ka ne dosje.

## E. MIRATIMI NGA KËSHILLI BASHKIAK

1) Pas **miratimit te listes** se aplikanteve perfitues, sektori i strehimit pergatit dokuentacionin me dosjet e kompletuara per tu miratuar per ne keshillin bashkiak (Projekt-vendim, relacion, shkrese, dokumentacion etj)

## F. NËNSHKRIMI I KONTRATËS

1) **Nenshkrimi** i kontrates behet tek Noteri, (bashkia, banka, individi).

## G. VERIFIKIMI NGA BASHKIA (INSPEKTIM NE BANESE)

1) Pas **miratimit** te listes se perfituesve ne bashki nga Sektori i strehimit dhe Keshilli bashkiak dhe Prefektura, behen verifikime ne banesa sipas kontrates (raport social mbi kushtet e jetesës)

Nr. 2486/1 Prot
18.06.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRODHIMIT STATISTIKOR
DREJTORIA E POPULLSISË DHE STATISTIKAVE SOCIALE

Tiranë, më 16.06.2026

Nr. 1331/1 Prot.

Lënda: Kthim përgjigje

**DREJTORISË SË EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË**
**ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE**
**Z. DRITAN BABUSHI**

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagjia: Nr. 2, Pogradec, Shqipëri,
Tel.+355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Në përgjigje suajës, nr.2486 Prot., datë 09.06.2026, "Kërkesë", për treguesit e shpenzimeve mesatare mujore të konsumit për familjen në qarkun Korçë sipas strukturës familjare", ju lutem gjeni në aneksin bashkëlidhur të dhënat mbi shpenzimet mesatare mujore për konsum të qarkut Korçë sipas madhësisë së NjEF, për vitin 2024. Këto detajime të treguesve të konsumit sipas qarqeve dhe madhësisë së NjEF, janë të pa publikuara dhe ju vihen në dispozicion vetëm për qëllime dhe analiza të brendshme institucionale, në kuadër të programeve sociale të strehimit që Bashkia Korçë ka në zbatim.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**
**Lantona Sado**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRODHIMIT STATISTIKOR
DREJTORIA E POPULLSISË DHE STATISTIKAVE SOCIALE

<u>Aneks:</u>

Tabelë: Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas madhësisë së NjEF dhe qarqeve, 2024*

*(në lekë)*

| Qarku | Madhësia e NjEF | | | | | Shpenzime mesatare mujore për konsum |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | NjEF me një person | NjEF me 2 persona | NjEF me 3 persona | NjEF me 4 persona | NjEF me 5+ persona | |
| Korçë | 57.923 | 82.823 | 94.293 | 110.096 | 112.783 | 91.418 |
| Shqipëri | 56.895 | 79.845 | 100.281 | 111.681 | 115.729 | 93.842 |

*Burimi: "Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare, 2024".*

**Shënim metodologjik: Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Census e Popullsisë dhe Banesave, 2023.*

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4) 2228300
www.instat.gov.al | info@instat.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC**

**DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE**

Pogradec, më 08.06.2026

Nr 2786 prot

Lënda : Kërkesë

**Drejtuar:**

**INSTITUTIT TË STTAISTIKAVE TIRANË**
**ADRESA: RR. "VLLAZËN HUTA", ND.35, H 1, TIRANË**
*Tel: +355 (4) 2233356 / 2233358*

*Të nderuar!*

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, Ligji 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", referuar programeve të strehimit dhe thirrjes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit kërkojmë nga ju informacion zyrtar për tregnesit e shpenzimeve mesatare mujore të konsumit për familjen në qarkun Korçë sipas strukturës familjare (1-2 persona, 3 persona, 4 persona dhe mbi 5 persona).

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin mbetemi në pritje të përgjigjes suaj brenda afateve ligjore!

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

**(ME URDHER DHE DELEGIM)**
**SEKRETAR I PERGJITHSHËM**
**DRITAN BABASULI**

Bulevardi "[illegible] Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 535/2 prot                                        Pogradec, më 08.06.2026

Lënda : Ftesë për bashkëpunim.

Drejtuar:

**BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË POGRADEC**
**RAIFFEISEN BANK, BKT, ABI BANK, CREDINS, OTP BANK, UNION BANK**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 22/2018 " Për strehimin Social", si dhe shkresës se Ministrise se Ekonomise dhe Inovacionit me nr.682/2.prot dt.23.01.2026 për fondet e programet e strehimit për vitin 2026 konkretisht per Porgramin per Subvencionim te Interesave te Kredise per familjet e reja aplikuese ne bashki, kërkojmë: Nëse i përgjigjeni pozitivisht ose jo programit të subvencionimit të kredisë së butë e cila sipas Ligjit nr.22/2018 'Për strehimin social" mbulohet kryesisht nga fondet e Bashkisë dhe Ministrisë të Ekonomisë dhe Inovacionit.

Bashkia Pogradec i përgjigjet pozitivisht thirrjes për subvencionim të kredisë së butë sipas shkresës së Ministrisë të Ekonomisë dhe Inovacionit mr nr.628/2.prot, dt. 23.01.2026.

Ju lutem kërkojmë nga ju çfarë interesi preferencial dhe çfarë formule llogaritje të këstit na ofroni për katër fashat e kredisë sipas tabelës së aneksit nr.1 bashkalidhur kësaj kërkese.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin presim bashkëpunimin tuaj!

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

**(ME URDHER DHE DELEGIM)**
**SEKRETAR I PERGJITHSHËM**
**DRITAN [illegible]**

Bulevardi "Reshit Collaku", Lagja Nr.2, Tel: +355 (83) 2222? , Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC**

**DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE**

Nr. 535/3 prot Pogradec, më 08.06.2026

Lënda : Kërkesë

Drejtuar:

**AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**
**DREJTORIA VENDORE POGRADEC**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 22/2018 " Për strehimin Social", si dhe shkresës se Ministrise se Ekonomise dhe Inovacionit me nr.682/2.prot dt.23.01.2026 për fondet e programet e strehimit për vitin 2026 konkretisht per Porgramin për Subvencionim te Interesave te Kredise për familjet e reja aplikuese ne bashki, kërkojmë nga ju informacion për referencën e çmimit të apartamenteve në qytetin e Pogradecit për /m2 sipas VKM-ve dhe Ligjeve në fuqi për kadastrën..

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

**(ME URDHER DHE DELEGIM)**
**SEKRETAR I PERGJITHSHËM**
**DRITAN BABASULI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA POGRADEC

Bulevardi "Reshit Collaku", Pallati Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

VENDIM
Nr. 89, datë 3.2.2016

## PËR MIRATIMIN E HARTËS SË VLERËS SË TOKËS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë, sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vendimi nr. 514, datë 30.7.2014, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 457, datë 26.7.2023

# PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 132, DATË 7.3.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR METODOLOGJINË PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME "NDËRTESA", E BAZËS SË TAKSËS PËR KATEGORI SPECIFIKE, NATYRËN DHE PRIORITETIN E INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË TAKSËS, SI DHE TË KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN ALTERNATIV TË DETYRIMIT TË TAKSËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, 22/1, 22/3 e 22/4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anekset 1 dhe 2, që i bashkëlidhen vendimit nr. 132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohen, përkatësisht, me aneksët 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

## ANEKSI 1
## ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR BANESAT

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së:

a) ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve.

a.1) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve (me përjashtim të Bashkisë Tiranë):

| Nr. r. qarkut | Qarku | Nr. r. bashkie | Bashkia | Nr. r. qytete | Nr. r.qytet i qarkut | Qytetet | Lek/m² sipërfaqe shfrytëzimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Berat | 1 | Berat | 1 | 1 | Berat | 41 400,00 lekë |
| | | 2 | Poliçan | 2 | 2 | Poliçan | 26 000,00 lekë |
| | | 3 | Ura Vajgurore | 3 | 3 | Ura Vajgurore | 37 000,00 lekë |
| | | 4 | Kuçovë | 4 | 4 | Kuçovë | 36 000,00 lekë |
| | | 5 | Skrapar | 5 | 5 | Çorovodë | 25 000,00 lekë |
| 2 | Dibër | 6 | Dibër | 6 | 1 | Peshkopi | 49 000,00 lekë |
| | | 7 | Mat | 7 | 2 | Burrel | 44 300,00 lekë |
| | | 8 | Klos | 8 | 3 | Klos | 32 000,00 lekë |
| | | 9 | Bulqizë | 9 | 4 | Bulqizë | 41 800,00 lekë |
| 3 | Durrës | 10 | Durrës | 10 | 1 | Durrës | 67 500,00 lekë |
| | | 11 | Shijak | 11 | 2 | Shijak | 41 000,00 lekë |
| | | 12 | Krujë | 12 | 3 | Krujë | 48 500,00 lekë |
| | | | | 13 | 4 | Fushë-Krujë | 51 000,00 lekë |
| 4 | Elbasan | 13 | Elbasan | 14 | 1 | Elbasan | 50 300,00 lekë |
| | | 14 | Belsh | 15 | 2 | Belsh | 35 000,00 lekë |
| | | 15 | Cërrik | 16 | 3 | Cërrik | 38 300,00 lekë |
| | | 16 | Peqin | 17 | 4 | Peqin | 39 000,00 lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 17 | Librazhd | 18 | 5 | Librazhd | 44 000,00 lekë |
| | | 18 | Përrenjas | 19 | 6 | Përrenjas | 41 780,00 lekë |
| | | 19 | Gramsh | 20 | 7 | Gramsh | 43 000,00 lekë |
| 5 | Fieri | 20 | Fier | 21 | 1 | Fier | 53 100,00 lekë |
| | | 21 | Patos | 22 | 2 | Patos | 28 000,00 lekë |
| | | 22 | Roskovec | 23 | 3 | Roskovec | 30 000,00 lekë |
| | | 23 | Lushnjë | 24 | 4 | Lushnjë | 40 100,00 lekë |
| | | 24 | Divjakë | 25 | 5 | Divjakë | 40 100,00 lekë |
| | | 25 | Mallakastër | 26 | 6 | Ballsh | 30 000,00 lekë |
| 6 | Gjirokastër | 26 | Gjirokastër | 27 | 1 | Gjirokastër | 47 400,00 lekë |
| | | 27 | Dropull | 28 | 2 | Sofratikë | 27 000,00 lekë |
| | | 28 | Libohovë | 29 | 3 | Libohovë | 27 000,00 lekë |
| | | 29 | Përmet | 30 | 4 | Përmet | 37 000,00 lekë |
| | | 30 | Këlcyrë | 31 | 5 | Këlcyrë | 24 600,00 lekë |
| | | 31 | Tepelenë | 32 | 6 | Tepelenë | 32 500,00 lekë |
| | | 32 | Memaliaj | 33 | 7 | Memaliaj | 15 000,00 lekë |
| 7 | Korçë | 33 | Korçë | 34 | 1 | Korçë | 45 800,00 lekë |
| | | 34 | Maliq | 35 | 2 | Maliq | 27 800,00 lekë |
| | | 35 | Pustec | 36 | 3 | Pustec | 35 000,00 lekë |
| | | 36 | Devoll | 37 | 4 | Bilisht | 35 000,00 lekë |
| | | 37 | Pogradec | 38 | 5 | Pogradec | 49 900,00 lekë |
| | | 38 | Kolonjë | 39 | 6 | Ersekë | 23 000,00 lekë |
| | | | | 40 | 7 | Leskovik | 21 000,00 lekë |
| 8 | Kukës | 39 | Has | 41 | 1 | Krumë | 24 500,00 lekë |
| | | 40 | Kukës | 42 | 2 | Kukës | 54 000,00 lekë |
| | | 41 | Tropojë | 43 | 3 | Bajram Curri | 27 900,00 lekë |
| 9 | Lezhë | 42 | Lezhë | 44 | 1 | Lezhë | 56 000,00 lekë |
| | | | | 45 | 2 | Shëngjin | 56 000,00 lekë |
| | | 43 | Kurbin | 46 | 3 | Laç | 42 500,00 lekë |
| | | | | 47 | 4 | Milot | 34 000,00 lekë |
| | | 44 | Mirditë | 48 | 5 | Rrëshen | 42 000,00 lekë |
| | | | | 49 | 6 | Rubik | 29 500,00 lekë |
| 10 | Shkodër | 45 | Shkodër | 50 | 1 | Shkodër | 58 000,00 lekë |
| | | 46 | Vau i Dejës | 51 | 2 | Vau i Dejës | 24 300,00 lekë |
| | | 47 | Malësi e Madhe | 52 | 3 | Koplik | 40 500,00 lekë |
| | | 48 | Pukë | 53 | 4 | Pukë | 22 000,00 lekë |
| | | 49 | Fushë-Arës | 54 | 5 | Fushë-Arës | 7 500,00 lekë |
| 11 | Tiranë | 50 | Kavajë | 55 | 1 | Kavajë | 51 000,00 lekë |
| | | 51 | Rrogozhinë | 56 | 2 | Rrogozhinë | 41 000,00 lekë |
| | | 52 | Vorë | 57 | 3 | Vorë | 51 500,00 lekë |
| | | 53 | Kamzë | 58 | 4 | Kamzë | 52 000,00 lekë |
| 12 | Vlorë | 54 | Sarandë | 59 | 1 | Sarandë | 56 000,00 lekë |
| | | 55 | Konispol | 60 | 2 | Konispol | 28 000,00 lekë |
| | | 56 | Finiq | 61 | 3 | Livadhja | 28 000,00 lekë |
| | | 57 | Vlorë | 62 | 4 | Vlorë | 61 800,00 lekë |
| | | | | 63 | 5 | Orikum | 60 000,00 lekë |
| | | 58 | Himarë | 64 | 6 | Himarë | 58 000,00 lekë |
| | | 59 | Selenicë | 66 | 7 | Selenicë | 25 000,00 lekë |
| | | 60 | Delvinë | 67 | 8 | Delvinë | 26 750,00 lekë |

a.2) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë:

| Bashkia Tiranë | Nr. i njësisë administrative | Nr. rendor | Zona | Lek/m² sipërfaqe shfrytëzimi |
|---|---|---|---|---|
| Qyteti Tiranë sipas ndarjeve sociale për | 1 | 1 | 1/1 | 102,800.00 |
| | | 2 | 1/2 | 97,200.00 |

# Zgjidhni raportin e çmimeve që doni të shikoni

SHITJE PËR QIRA

QARKU: Korçë

QYTET: Pogradec

ZONA: Pogradec

SHIKO RAPORTIN

N/A
Çmimi për m2 në Pogradec 2023

499 € /m2
Çmimi për m2 në Pogradec 2019

SHIKO TË GJITHA | 6 VITET | 2 VITET | 1 VIT




| Vendndodhja | VKM 2023 | VKM 2019 |
| --- | --- | --- |
| Korça | N/A | N/A |
| Maliq | N/A | N/A |
| Pustec | N/A | N/A |
| Bilisht | N/A | N/A |
| Pogradec | N/A | 499 € /m2 |
| Ersekë | N/A | N/A |
| Leskovik | N/A | N/A |

BASHKIA POGRADEC
R 535/6 PROT
26.06.2026

STREHIMI

otpbank

Nr. 2957 Prot

Tiranë më 25 Qershor, 2026

Drejtuar: Bashkia Pogradec

Z.Ilir Xhakolli, Kryetar

Nga: Banka OTP Albania sha

Lënda: Paraqitje oferte

I nderuar Z.Ilir Xhakolli,

Në vijim të shkresës tuaj datë 08.06.2026 me nr. protokolli 535/2 me subjekt "Ftesë per bashkëpunim" në kuadër të programit për strehim Social për " Programin për Subvencionim i Interesave të Kredisë për familjet e reja", kemi kënaqësinë t'ju paraqesim bashkëngjitur oferten e Bankës OTP Albania.

Për cdo informacion shtesë në lidhje me sa më lart, mbetemi në dispozicion.

Me respekt,
Bledar SHELLA

Banka OTP Albania sh.a.
Drejtoria e Përgjithshme